



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA PËR TË DHËNAT E HAPURA DHE KONSULTIMIN PUBLIK

Nr. 757 prot.

Tiranë më 11.03.2026

URDHËR

Nr. 53, datë 11.03.2026

PËR MIRATIMIN E “MANUALIT TË MONITORIMIT ONLINE DHE
METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE TË HAPURA
NGA ORGANET E SEKTORIT PUBLIK DHE SIPËRMARRJET PUBLIKE”

Në mbështetje të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, Udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2025 “Për miratimin e licencës standarde të ripërdorimit të informacionit të sektorit publik” dhe kompetencave të Komisionerit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për ripërdorimin e informacionit të sektorit publik:

URDHËROJ:

1. Miratimin e Manualit të monitorimit online dhe Metodologjisë së vlerësimit të publikimit të të dhënave të hapura nga Organet e Sektorit Publik dhe Sipërmarrjet Publike, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri i cili është pjesë përbërëse e tij.
2. Manuali dhe Metodologjia, të miratuara me këtë urdhër kanë për qëllim:
 - garantimin e një procesi të unifikuar, objektiv dhe transparent monitorimi;
 - rritjen e nivelit të përputhshmërisë ligjore të organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike;
 - mbështetjen e procesit të raportimit dhe ndjekjes së detyrimeve ligjore për të dhënat e hapura;
3. Ngarkohet Drejtoria për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik, pranë Drejtorisë së Përgjithshme për të Drejtën e Informimit në KDIMDP për zbatimin e këtij urdhri.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi